VENDIM
Nr.2, datë 10.3.2010

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË ADMINISTRIMIT TË REGJISTRIMIT TË TË DHËNAVE, TË HEDHJES SË TË DHËNAVE, TË PËRPUNIMIT DHE NXJERRJES SË TYRE

Mbështetur në ligjin nr.9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe vendimeve të Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.9.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", nr.225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", si dhe në përputhje me detyrimet e përcaktuara në pikën 6 të nenit 27 të ligjit të lartpërmendur,

VENDOSA:

Përcaktimin e procedurave të administrimit të regjistrimit të të dhënave, të hedhjes së të dhënave, të përpunimit dhe nxjerrjes së tyre në zbatim të kërkesave të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", si më poshtë vijon:

I. Administrimi i regjistrimit

1. Mbajtja dhe ruajtja e të dhënave të bëhet vetëm për një apo disa qëllime të specifikuara, të qarta dhe të ligjshme.

a) Të dhënat mund të mbahen vetëm për një apo disa qëllime specifike, për qëllime të ligjshme dhe të deklaruara në mënyrë të qartë, dhe përpunimi i tyre duhet të bëhet vetëm mbi bazën e këtyre qëllimeve.

b) Në përputhje me këtë rregull duhet:

i) çdo individ të njohë arsyen e mbledhjes dhe mbajtjes së të dhënave të tij;

ii) qëllimi për të cilin mblidhen të dhënat, duhet të jetë i ligjshëm;

iii) të jeni të vetëdijshëm për administrimin e të dhënave që ju mbani.

2. Të dhënat të mbahen në mënyrë korrekte, të kujdesshme, të sakta, të plota dhe të përditësuara.

a) Individit t'i plotësohen të gjitha të drejtat e parashikuara në ligjin "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

b) Duhet që në interes të aktivitetit ose biznesit tuaj të siguroni të dhëna të sakta me qëllim të efikasitetit dhe vendimmarrjes efektive.

c) Në përputhje me këtë rregull ju duhet të siguroni:

i) procedurat tuaja zyrtare dhe kompjuterike të jenë të mjaftueshme për verifikime të përshtatshme për të siguruar nivele të larta të saktësisë së të dhënave;

ii) kërkesat e përgjithshme për mbajtjen e të dhënave personale të përditësuara të jenë shqyrtuar plotësisht;

iii) të jenë vendosur, aplikuar, zbatuar procedurat e përshtatshme, duke përfshirë rishikimin periodik dhe kontrollin, për të siguruar që çdo e dhënë është mbajtur e përditësuar;

3. Të dhënat të mbahen jo më shumë se sa është e nevojshme për qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej.

a) Kontrolluesit e të dhënave kanë përgjegjësi dhe duhet të jenë të qartë në lidhje me hapësirën kohore për të cilat të dhënat do të ruhen dhe arsyen përse informacioni është duke u mbajtur.

b) Ju duhet të përcaktoni një person përgjegjës për të siguruar që dosjet ose bazat e të dhënave të monitorohen rregullisht, me qëllim që të dhënat personale të mos mbahen më gjatë se koha e nevojshme.

c) Ju duhet të keni:

i) një politikë të përcaktuar për periudhën e mbajtjes së të gjithë të dhënave personale në zbatim të udhëzimeve të Komisionerit;

ii) rregulla të përcaktuara e miratuara për menaxhimin, procedurat zyrtare dhe kompjuterike që zbatohen për të implementuar një politikë të tillë.

4. E drejta e aksesit të subjektit të të dhënave

a) Çdo individ për të cilin ju mbani të dhëna personale ka të drejtë:

i) të marrë një kopje të të dhënave që ju mbani rreth tij apo saj;

ii) të dijë kategoritë e të dhënave të tyre dhe qëllimin/et tuaj për përpunimin e tyre;

iii) të dijë identitetin e atyre të cilëve ju i keni përhapur të dhënat;

iv) të dijë burimin e të dhënave, nëse nuk vjen në kundërshtim me interesin publik;

v) të dijë logjikën, arsyetimin e përfshirë në vendimet automatike;

vi) të dijë mbi të dhëna të mbajtura në formën e opinioneve, përveç kur opinione të tilla janë dhënë në mënyre konfidenciale ose fshehtësi dhe madje edhe në raste të tilla ku të drejtat themelore të njeriut të sugjerojnë se ata duhet të kenë akses te të dhënat në fjalë.

b) Kontrolluesit të kenë procedura të qarta koordinimi, në mënyrë që të sigurohen se të gjitha dosjet përkatëse manuale dhe kompjuterike janë kontrolluar për të dhënat në lidhje me të cilat është bërë kërkesa e aksesit.

c) Për të bërë një kërkesë për akses subjekti i të dhënave duhet:

i) të aplikojë me shkrim te ju (që mund të përfshijë dhe aplikimin me e-mail);

ii) të japë ndonjë hollësi, e cila mund të jetë e nevojshme për t'ju ndihmuar në identifikimin e atij/asaj dhe në gjetjen, lokalizimin e të gjitha informacioneve që ju mund të mbani rreth tij/saj;

d) Në përgjigje të kërkesës për akses ju duhet të:

i) pajisni individët me informacion në mënyrë të përpiktë dhe brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës;

ii) ofroni informacionin të qartë për personat, si p.sh. çdo kod duhet të shpjegohet.

e) Nëse ju nuk dispononi ndonjë informacion në lidhje me kërkesën e bërë nga individi, ju duhet t'ju komunikoni këtë brenda 30 ditëve.

f) Nëse ju kufizoni të drejtën e individëve për akses, në përputhje me një nga ato pak kufizime të parashikuara në ligj, të njoftohet subjekti i të dhënave në formë shkresore brenda 30 ditëve dhe të përfshini një deklaratë për arsyet e refuzimit. Gjithashtu, të informohet individi për të drejtën e tij/saj për t'u ankuar te Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave në lidhje me refuzimin ose për të paraqitur kërkesën për të kontrolluar përjashtimin në rastin konkret.

g) Çdo individ për të cilin një kontrollues të dhënash mban të dhëna personale, ka edhe një sërë të drejtash të tjera në bazë të ligjit, veç të drejtës për akses. Në to përfshihen e drejta për të kërkuar fshirjen apo korrigjimin e ndonjë informacioni të pasaktë, e drejta për të kundërshtuar, e drejta për t'u ankuar te Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave etj.

5. Siguria e të dhënave (neni 27)

a) Të merren masat e duhura të sigurisë kundër aksesit të paautorizuar, ndaj zbulimit apo shkatërrimit të të dhënave, si dhe për humbjen aksidentale të tyre. Standarde të larta të sigurisë të jenë thelbësore për të gjitha të dhënat personale;

b) Një standard minimal i sigurisë do të përfshinte:

i) të drejtën e specialistit IT në kufizimin e numrit të personelit sipas procedurave të përshtatshme;

ii) kodimin me fjalëkalime të sistemeve kompjuterike;

iii) mbajtjen të fshehur të informacionit që ndodhet në ekranin e kompjuterëve tuaj dhe dosjeve manuale prej personave të paautorizuar, të cilët kërkojnë të njihen me të dhëna;

iv) marrjen e të gjitha masave teknike për sigurimin e të dhënave, garantimin e veprimeve teknike për gjetjen, gjurmimin dhe përcaktimin e veprimeve me të dhënat nëpërmjet elementeve të veçanta që ka programi kompjuterik i aplikuar, si dhe ndërgjegjësimin e stafit për këtë;

v) shkatërrimin e përshtatshëm dhe hedhjen në vendin e duhur të të gjitha akteve dhe dokumentacionit që përmban të dhëna personale të panevojshme, pasi mbaron qëllimi i mbledhjes, mbajtjes dhe i përpunimit të tyre, si dhe hapësira kohore e përcaktuar për qëllim (duhet kuptuar që i tërë procesi që nga grumbullimi e deri te shkatërrimi i të dhënave, përfshirë edhe këtë të fundit, quhet përpunim dhe mbart të njëjtën përgjegjësi për kontrolluesit në rast shkelje të rregullave);

vi) vendosjen e një personi të caktuar që të jetë përgjegjës për sigurinë e të dhënave dhe për përditësimin e tyre;

vii) garantimin e zbatueshmërisë së udhëzimeve të përgjithshme dhe të veçanta të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për sigurinë e të dhënave personale.

6. Transferimi i të dhënave

a) Kur ka të bëjë me çështje lidhur me nivelin e mjaftueshmërisë së mbrojtjes së të dhënave personale, do të shqyrtohet tipi i të dhënave personale, qëllimi i përdorimit dhe kohëzgjatja e përpunimit të të dhënave, legjislacioni i vendit transferues dhe legjislacioni i vendit marrës, përfshirë këtu çështje lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve të huaj dhe masat për mbrojtjen e të dhënave personale të përdorura nga këto vende. Vendimi i dhënë në këto raste do të bazohet në këto pika:

i) nëse të dhënat janë përdorur për qëllimin që janë transferuar, nëse qëllimi mund të ndryshohet, por vetëm me konsensusin e kontrolluesit të të dhënave, i cili ka transferuar të dhënat dhe në bazë të pëlqimit të personit me të cilin lidhen të dhënat;

ii) nëse individi mund të mësojë qëllimin për të cilin të dhënat e tij/saj janë përdorur, kujt i janë dhënë, dhe nëse mund të korrigjohen apo fshihen në rastet kur janë të papërshtatshme, janë mbledhur pa kujdes ose nuk janë të përditësuara, e në këtë rast për shkak të konfidencialitetit të procedurës do të duhet implementimi i një marrëveshjeje ndërkombëtare;

iii) nëse një kontrollues i huaj zbaton të njëjtat procedura, mjete e masa për mbrojtjen e të dhënave personale;

iv) nëse është përcaktuar një person i autorizuar, i aftë për të dhënë informacion në këtë fushë;

v) nëse një marrës i huaj mund të transferojë të dhëna vetëm nën kushtin që edhe vendi tjetër i huaj ku transferohen të dhënat të sigurojë një mbrojtje të mjaftueshme të të dhënave të qytetarëve të huaj;

vi) nëse është siguruar një mbrojtje e mjaftueshme ligjore për personat të cilëve u transferohen të dhënat.

II. Hedhja e të dhënave (nenet 5, 6, 20, 22, 27)

1. Marrja, mbledhja, grumbullimi, si dhe hedhja e të dhënave në programe kompjuterike apo në baza të dhënash të ngritura dhe të përcaktuara, si dhe për krijimin e dosjeve manuale, për menaxhimin e aktivitetit tuaj duhet të kryhet në mënyrë të drejtë.

2. Për të marrë të dhëna në mënyrë të drejtë, subjekti i të dhënave, në kohën kur të dhënat janë duke u mbledhur, duhet të bëhet me dije dhe të informohet për:

a) Emrin e subjektit kontrollues;

b) Qëllimin e mbledhjes së të dhënave;

c) Identitetin e ndonjë përfaqësuesi të caktuar për qëllimin e ligjit;

d) Personat ose kategoritë e personave, të cilëve mund t'ju zbulohen të dhënat;

e) Ekzistencën e së drejtës së aksesit në të dhënat e tyre personale;

f) Të drejtën për të korrigjuar të dhënat e tyre të pasakta ose të përpunuara në mënyrë të padrejtë;

g) Raste kur të dhënat personale nuk janë marrë nga vetë subjekti i të dhënave, ose nuk janë marrë në kohën kur të dhënat e subjektit janë përpunuar për herë të parë, ose në kohën e deklarimit të një pale të tretë, si dhe të gjitha këto të dhëna duhet t'i sigurohen subjektit të të dhënave;

h) Emrin e subjekteve kontrolluese të të dhënave prej të cilëve janë marrë këto të dhëna, si dhe emrin e subjekteve kontrolluese të cilëve iu përhapen këto të dhëna.

3. Hedhja e të dhënave dhe përpunimi i tyre duhet të përcaktohen si objekt parësor i kontratës së lidhur ndërmjet subjektit kontrollues dhe përpunuesve bazuar në qëllimin për të cilin do të kërkohen, mblidhen, do të hidhen apo do të përpunohen në mënyrë manuale apo automatike (kompjuterike).

4. Kontrata duhet të përcaktojë kushtet dhe kriteret mbi bazën e të cilave të dhënat kërkohen, mblidhen, hidhen apo përpunohen në mënyrë manuale ose automatike (kompjuterike) nga përpunuesi/t i të dhënave i përcaktuar në këtë kontratë.

5. Kontrata duhet të përcaktojë kushtet teknike të sigurisë të të dhënave, si dhe të përcaktojë që këto të dhëna duhet të fshihen në momentin e përfundimit të kontratës.

6. Subjektet kontrolluese duhet të ndërmarrin masat e nevojshme për të garantuar zbatimin e kushteve dhe të kritereve të përcaktuara në kontratë nga ana e përpunuesve.

III. Përpunimi i të dhënave (nenet 5,6,7)

1. Për një përpunim të drejtë, të dhënat personale duhet të merren në mënyrë të drejtë dhe subjekti i të dhënave duhet të ketë dhënë pëlqimin e tij për përpunimin e tyre.

2. Të dhënat mund të përpunohen pa pëlqimin e subjektit të të dhënave kur përpunimi është i nevojshëm për një nga arsyet e mëposhtme:

a) për ekzekutimin e një kontrate në të cilën subjekti i të dhënave është palë;

b) kur përpunimi bëhet për një detyrim ligjor;

c) për të parandaluar dëmtimin e shëndetit të subjektit të të dhënave;

d) për të parandaluar humbje të rënda ose dëmtim të pasurisë së subjektit të të dhënave;

e) për të mbrojtur interesat jetikë të subjektit;

f) kur përpunimi bëhet në kuadrin ligjor të veprimtarive të parandalimit dhe ndjekjes penale, si dhe në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare, kur përpunimi kryhet nga autoritete kompetente të përcaktuara me ligj;

g) për kryerjen e një funksioni tjetër të një natyre publike të kryera në interes të publikut nga një person;

h) për qëllim të interesave legjitime të kontrolluesit të të dhënave, përveçse kur në çdo rast të veçantë përpunimi i të dhënave është i pajustifikuar.

3. Për të pasur një përpunim të drejtë të të dhënave sensitive, këto të dhëna duhet të jenë marrë në mënyrë të drejtë dhe duhet të plotësohet të paktën njëri nga këto kushte:

a) Subjekti i të dhënave të ketë shprehur pëlqimin e tij të qartë, të kuptueshëm dhe në formë të shkruar për përpunimin e të dhënave të tij sensitive, pasi të jetë informuar në mënyrë të plotë dhe të

kuptueshme për qëllimin e përpunimit të këtyre të dhënave. Në rastet kur këto subjekte nuk janë në gjendje ta bëjnë një gjë të tillë, për arsye të pamundësisë fizike dhe mendore, si dhe të moshës, pëlqimi duhet të jepet nga njëri prind ose nga kujdestari ligjor (duhet mbajtur parasysh parimi se, pëlqimi i subjektit nuk mund të legjitimojë një përpunim që është i ndaluar me ligj të veçantë);

b) Kur subjektet nuk kanë shprehur pëlqimin e tyre, por përpunimi është i nevojshëm për një nga arsyet e mëposhtme:

i) për ushtrimin apo përmbushjen e detyrimeve apo ndonjë të drejte nga subjektet kontrolluese në fushën e punësimit të parashikuara në ligj;

ii) për të parandaluar dëmtime të shëndetit të subjektit të të dhënave ose të një personi tjetër, ose cenim të personalitetit të tij;

iii) për të parandaluar humbjen apo dëmtimin e pronës, dhe për të mbrojtur interesat jetikë të subjektit të të dhënave, në ato raste kur pëlqimi nuk mund të jepet për arsye të ndryshme;

iv) për të parandaluar dëmtimin e shëndetit të një personi tjetër, apo cenimin e personalitetit të tij, dëmtimin e pronës së një të treti, në ato raste kur pëlqimi ka qenë i fshehur;

v) kur është realizuar nga një organizatë jofitimprurëse, brenda anëtarëve të saj, ose të personave që kanë lidhje me ketë organizatë;

vi) kur të dhënat e përpunuara janë bërë publike si rezultat i nismës së subjektit të të dhënave;

vii) për qëllim të marrjes së këshillave ligjore, ose kur kanë të bëjnë me procedurat ligjore;

viii) për qëllime mjekësore;

ix) për qëllimin e pagesës së një detyrimi tatimor;

x) në lidhje me mirëqenien sociale.

4. Të dhënat duhet të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe jo të tepërta.

a) Sigurohuni që jeni duke kërkuar dhe mbajtur vetëm minimumin e të dhënave personale, të cilat ju nevojiten për arritjen e qëllimit/ve tuaj/a;

b) Vendosni për kriteret e veçanta me të cilat do të vlerësoni se çfarë është e përshtatshme, e nevojshme dhe jo e tepërt, si dhe zbatoni e përdorini këto kritere për çdo njësi informacioni apo të dhënash personale për qëllimi/et për të cilat janë mbledhur apo janë mbajtur të dhënat;

c) Siguroni që informacioni i kërkuar, i mbledhur, i mbajtur dhe i përpunuar është:

i) i mjaftueshëm në lidhje me qëllimin/et për të cilat e keni kërkuar atë;

ii) i përshtatshëm në lidhje me qëllimin/et për të cilat e keni kërkuar atë;

iii) jo i tepërt në lidhje me qëllimin/et për të cilat e keni kërkuar atë.

d) Kryeni një rishikim periodik për rëndësinë e të dhënave personale të kërkuara nga subjektet e të dhënave nëpërmjet kanaleve të ndryshme nga të cilat është mbledhur informacioni, d.m.th. forma, adresa interneti etj., si dhe duhet gjithashtu të ndërmerret një inspektim në kriteret bazë të mësipërme të ndonjë informacioni personal tashmë të mbajtur.

IV. Nxjerrja (përhapja) e të dhënave

1. Nxjerrja ose përhapja e të dhënave duhet të jetë në përputhje më qëllimin/met për të cilin/at ato janë mbledhur, mbajtur ose përpunuar;

2. Një provë konkrete e përputhshmërisë mund të jetë:

a) Nëse përdorimi i të dhënave bëhet vetëm sipas qëllimit/eve për të cilat ato mbahen.

b) Nëse i nxirrni apo i përhapni të dhënat sipas këtij qëllimi ose qëllimeve.

c) Nëse i nxirrni apo i përhapni të dhënat te vetë subjekti i të dhënave apo te subjekte të tjera kontrolluese me pëlqimin e vetë subjektit të të dhënave.

d) Nëse nxjerrja ose përhapja bëhet sipas kërkesave të parashikuara në ligj.

e) Nëse përpunuesi i të dhënave i përcaktuar nga ju i përpunon të dhënat bazuar në ligj, në këtë vendim apo sipas udhëzimeve të Komisionerit.

V. Konfidencialiteti (neni 28)

Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj.

Në të gjitha rastet kjo nënkupton që ata nuk duhet t'i bëjnë me dije ndonjë personi të paautorizuar të dhëna personale, të cilat ata i shohin apo që i mësojnë gjatë punës. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit zgjat pambarimisht. Detyrimi nuk mbaron kur personat nuk ushtrojnë më funksionet e tyre. Thyerja e detyrimit të konfidencialitetit përbën vepër penale të parashikuar nga Kodi Penal (neni 123).

Janë përgjegjës për zbatimin e kërkesave të këtij vendimi të gjithë kontrolluesit publikë dhe privatë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERE
Flora Çabej (Pogaçe)